



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

---

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.11.2023, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NPL-SË**  
**"SPORT MARKETING"**

**I.**

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së "Sport Marketing", SHA.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 50.000,00 € (pesëdhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

**III.**

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, NPL-së "Sport Marketing", SHA, për shkakë të problemeve financiare me të cilat po përballlet kjo ndërmarrje.

**IV.**

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa e NPL-së "Sport Marketing", SHA.

**V.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-400/04-215744/23, më 03.11.2023

KRYESUESI I KUVENDIT  
Pëllumb Bajcinovci

